

LIGJ
Nr.8202, datë 27.3.1997

PËR AMNISTINË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Qeverisë së Pajtimit Kombëtar

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Të përjashtohen nga ndjekja penale dhe vuajtja e dënimit të mëtejshëm të gjithë personat civilë dhe ushtarakë, me përjashtim të atyre që kanë kryer:

a) vrasje me dashje ose me paramendim, të parashikuara si vepra penale nga nenet 76, 77, 78 e 79 të Kodit Penal dhe 77 të Kodit Penal Ushtarak;

b) marrëdhënie seksuale me dhunë, të parashikuara nga nenet 100, 101/2, 102, 103 e 104 të Kodit Penal;

c) rrëmbim personi, të parashikuar nga neni 109-a të Kodit Penal;

d) shfrytëzim të prostitucionit, të parashikuar nga nenet 114, 114-a dhe 114-b të Kodit Penal;

dh) vjedhje të pasurisë, të parashikuar nga nenet 135, 136, 141, vjedhje të pasurisë private, të parashikuar nga nenet 139, 140 të Kodit Penal, si dhe vjedhje të pronës ushtarake, me pasojë vdekje, të parashikuar nga neni 59/2 i Kodit Penal Ushtarak;

e) mashtrim të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal;

ë) genocid dhe krime kundër njerëzimit të parashikuara, përkatësisht nga nenet 73 e 74 të Kodit Penal;

f) tortura me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 87 i Kodit Penal;

g) krime kundër pavarësisë dhe integritetit të vendit, të parashikuar nga nenet 208, 209, 210, 211, 212, 217 dhe 218 të Kodit Penal;

gj) krime kundër rendit kushtetues, të parashikuar nga nenet 219 e 220 të Kodit Penal;

h) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtete të tjera, të parashikuar nga nenet 226, 227, 228 e 229 të Kodit Penal;

i) akte terroriste të parashikuara nga neni 230 i Kodit Penal.

Neni 2

Të gjithë personave, që janë në ndjekje penale ose janë të dënuar për kryerjen e krimeve të përmendura në nenin 1, u falet 1/3 e dënimit nëse kthehen vullnetarisht në burg brenda datës 12.4.1997, ndërsa të dënuarve me burgim të përjetshëm apo me vdekje u kthehet në 20 vjet burgim.

Neni 3

Nga kjo amnisti nuk përfitojnë personat që kanë kryer vepra penale, të parashikuara nga nenet 256, 257, 258, 259 e 260 të Kodit Penal.

Neni 4

Personat që përfitojnë nga kjo amnisti dhe brenda një periudhe pesëvjeçare nuk kryejnë vepra penale të njëjta ose më të rënda nga ato për të cilat janë amnistuar, nuk do të quhen të dënuar.

Neni 5

Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi më datën 5.4.1997.

Shallur me dekretin nr.1771, datë 3.4.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha